



## ORDO FRATRUM MINORUM

Provincia Françeskane “Zoja Nunciatë” në Shqipëri e Mal të Zi

Kuria e Provincës, L. Vasil Shanto, Rr. At' Gjergj Fishta 22, 4001 Shkodër - Albania  
Tel./fax: +355 222 42725, E-mail: sekretariaekustodies@gmail.com

---

Prot. nr. **123 /2023**

Shkodër, me **31.10.2023**

### DEKLARATË PUBLIKE

Enti Fetar, Provinca Françeskane “Zoja Nunciatë” me qendër në Shkodër është subjekt juridik shqiptar që prej vitit 1992, dhe ka shtrirje të pronave dhe objekteve fetare në pjesën më të madhe të territorit shqiptar.

Provinca Françeskane “Zoja Nunciatë” deklaron se distancohet dhe është kundër çdo lloj dhune.

➤ ***Në lidhje me ngjarjen e datës 29 Tetor 2023 në hyrje të Kepit të Rodonit bëjmë me dije sa më poshtë vijon:***

- Provinca ka lidhur një kontratë sipërmarrje kryerje punimesh me firmën AML Group shpk për kryerjen e instalimit të rrjetit të rrethimit ekzistues të pjesës jugore të pronës dhe ka filluar punën për zbatimin e kontratës.

- Policia e Manzës ka shkuar në mëngjesin e datës 29.10.2023 në hyrje të Kepit të Rodonit, pasi ishte njoftuar për ndërtim pa leje. Punonjësit e firmës AML Group shpk që po kryenin punimet aty, kanë sqaruar Policinë e Manzës duke i vënë në dispozicion dokumentacionin e nevojshëm dhe pasi u vërtetua se nuk bëhej fjalë për punime pa leje dhe se informacioni ishte i pasaktë, policia është larguar.

- Pas largimit të policisë, disa persona të identifikuar si familjarë të shtetasit Bajram Kaculi, kanë sulmuar me mjete të forta punëtorët e shoqërisë, e cila po zbatonte kontratën e sipërmarrjes. Për t'i ndarë ata, ka ndërhyrë një punonjës i Provincës i cili është dëmtuar dhe është dërguar me urgjencë në spital. Në vendngjarje ka ardhur policia që ka shoqëruar personat e përfshirë aty në konflikt nga të dy palët dhe çështja është në ndjekje nga organet proceduese.

➤ ***Në lidhje me Pronën e Provincës Françeskane “Zoja Nunciatë” në Kepin e Rodonit, sqarojmë sa më poshtë vijon:***

- Provinca Françeskane, ka përfituar pronësinë në territorin e Kepit të Rodonit me Vendimin nr. 416 datë 31.01.2008 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Qarku Durrës dhe nuk ka pasur konflikt me asnjë shtetas. Për pronësinë e pasurisë nr.30/6 ka paraqitur pretendim një shtetas i katundit Shetaj. Normalisht për një pretendim të tillë ai shtetas duhet t'i drejtohet gjykatës, pasi kjo pasuri është regjistruar nga Provinca që në vitin 2008, ndërsa ky shtetas e ka të regjistruar në vitin 2019.

Kjo pronë në Kepin e Rodonit është pronë e Provincës Françeskane Zoja Nunciatë dhe jo e Kishës Katolike në Shqipëri.

- Pas ngjarjes së datës 29.10.2023, në disa Media është theksuar fakti se shtetësja Ana Shtjefni është përfaqësuesja e Provincës Françeskane. Sqarojmë se kjo nuk është e vërtetë, znj Shtjefni nuk është përfaqësuese e Provincës Françeskane.

Mes Provincës Françeskane dhe znj. Shtjefni në cilësinë e administratores së Shoqërisë Albania Tourist Resort ka pasur një marrëdhënie kontraktuale qiraje me objekt pronën e Provincës në Kepin e Rodonit, kontratë e cila nuk ka më fuqi ligjore prej datës 14.04.2023 pasi është zgjidhur nga Provinca Françeskane, për arsye të mospagimit të qirasë nga qiramarrësja për më shumë se gjashtë muaj të njëpasnjëshëm, rast i përsëritur për të dytën herë në harkun kohor të dy viteve. Që prej kësaj date, znj. Shtjefni nuk ka më asnjë të drejtë mbi këtë pronë.

Paqe e të mira!



*Fra Pashko Gojcaj*

Fra Pashko Gojcaj OFM  
Ministër Provincial